



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Këshilli Prokurorial i Kosovës  
Tužilački Savet Kosova  
Kosovo Prosecutorial Council



Prokurori i Shtetit  
Državni Tužilac  
State Prosecutor

# PLANI STRATEGJIK I SISTEMIT PROKURORIAL 2022-2024







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Këshilli Prokurorial i Kosovës  
Tužilački Savet Kosova  
Kosovo Prosecutorial Council



Prokurori i Shtetit  
Državni Tužilac  
State Prosecutor

# PLANI STRATEGJIK I SISTEMIT PROKURORIAL 2022-2024



## Përmbajtja

HYRJE.....	6
QËLLIMET STRATEGJIKE 2022-2024.....	7
METODOLOGJIA.....	9
PASQYRË E PËRGJITHSHME.....	12
Vizioni.....	12
Misioni.....	12
Vlerat.....	12
Struktura.....	12
Buxheti.....	16
Zhvillimi institucional.....	18
Shtylla I: Fuqizimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial.....	22
Shtylla II: Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të sistemit prokurorial.....	25
Shtylla III: Hetimi dhe ndjekja e kryesve të veprave penale, që reflekton profesionalizëm, përkushtim, efikasitet dhe respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut përmes zbatimit të standardeve më të larta profesionale dhe etike.....	28
Shtylla IV: Prioritezimi i hetimit të veprave penale dhe ndjekjes së kryesve të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ekonomike, pastrimit të parave, krimeve të luftës, terrorizmit dhe krimit kibernetik, dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes.....	33
Analiza SWOT.....	34
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2022-2024.....	36
Shtylla 1: Profesionalizmi dhe pavarësia në sistemin prokurorial.....	37
Shtylla 2: Efikasiteti dhe efektiviteti në ndjekjen e krimit.....	38

Shtylla 3: Profilizimi i prokurorëve dhe trajtimi i rasteve penale me prioritet.....	41
Shtylla 4: Menaxhimi dhe administrimi në sistemin prokurorial.....	44
Shtylla 5: Integriteti, llogaridhënia dhe etika.....	47
Shtylla 6: Transparenca në sistemin prokurorial.....	48
Monitorimi i zbatimit të Planit strategjik.....	49
Shtojca 1: Plani i veprimit.....	49

## Lista e shkurtesave

KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës

ZKPSH- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

PSRK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

PSH - Prokurori i Shtetit

SMIL - Sistemi për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve

BE - Bashkimi Evropian

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

SKPK - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës

NJSHPP - Njësi për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë

EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit

## HYRJE

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024 paraqet kornizën kryesore të planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës për tre vjetët e ardhshëm.

Plani ka për qëllim ngritjen e vazhdueshme të profesionalizmit, efikasitetit dhe menaxhimit të sistemit prokurorial, fuqizimin e pavarësisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës, duke u mbështetur gjithnjë në kompetencat kushtetuese dhe ligjore.

Ky plan ndihmon në ofrimin e drejtimit dhe fokusit për të gjithë punonjësit dhe ofron objektivat e përgjithshme dhe specifike, të cilat duhet të arrihen, si dhe paraqet aktivitetet dhe veprimet për t'i arritur ato. Plani strategjik ndihmon të gjitha njësitë përbrenda sistemit prokurorial për t'u koordinuar për arritjen e objektivave të parapara.

Fokus i rëndësishëm i këtij plani është edhe mosdyfishimi i punëve dhe aktiviteteve, që është bërë përmes analizës së asaj se çka është realizuar, çka është në proces dhe çka nuk është realizuar nga plani paraprak i tre vjetëve të kaluar.

Po ashtu, qëllimi i këtij plani është përfshirja e aktiviteteve të realizueshme dhe të dobishme për sistemin prokurorial dhe monitorimi i realizimit e zbatimit të tij gjatë tre viteve në vazhdim.


Plani ka përcaktuar qëllimet e veta në përmbajtje, duke filluar nga realizimi dhe gjer në përfundim të afatit të tij. Përcaktimi i qëllimeve është specifikuar edhe përmes Planit të veprimit, në të cilën tregohen rrugët që duhet ndjekur, buxheti dhe shumë faktorë të tjerë për realizimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024.



## QËLLIMET STRATEGJIKE 2022 – 2024

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024 (më tutje: Plani) përmban gjashtë shtylla, 36 objektiva strategjike dhe afro 160 aktivitete, për të cilat është hartuar edhe Plani i veprimit, në të cilin pasqyrohet mënyra e arritjes së këtyre objektivave dhe matja e tyre përmes treguesve dhe afateve kohore.

Këto gjashtë shtylla të tij paraqesin gjashtë fushat kryesore, në të cilat do të fokusohet sistemi prokurorial në tre vjetët e ardhshëm.



Duke e krahasuar me planin strategjik paraprak, ky plan i ri ka kaluar nga katër në gjashtë shtylla kryesore strategjike. Përmes këtij plani strategjik kemi pasur në fokus ndërlidhjen e performansës së sistemit prokurorial me nevojat e qytetarëve të Kosovës dhe kjo është një ndër arsyet kritike të kalimit nga katër shtylla në gjashtë shtylla, me ç’rast të shtylla e gjashtë “Transparenca në sistemin prokurorial” është vënë në fokus kryesor marrëdhënia e sistemit prokurorial me publikun.

Për më tepër, grupi punues ka rishikuar efektivitetin e vizionit dhe misionit të planit paraprak, ka rishikuar pozicionin e sistemit prokurorial, duke pasur parasysh ndryshimet thelbësore që kanë ndodhur përgjatë këtyre viteve, që, ndër të tjera, janë COVID-19, rishikimi funksional, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për pavarësinë

e sistemit prokurorial dhe të tjera, si dhe bazuar në këto ka hartuar një vizion dhe një mision të ri në linjë me këto dhe ndryshimet e tjera në sistemin prokurorial.

Kalimi nga 4 shtylla 6

A

**PSE DUHET TË NDRYSHOJMË? CILAT JANË OBJEKTIVAT TONA KRYESORE?**

Strategjia jonë e mëparshme ka qenë e suksesshme, por ne duhet të bëjmë më shumë për tu afruar me qytetarët e Kosovës. Të shfaqim punën tonë të mirë dhe të përmirësojmë mangësitë e tona kritike. Rishikimi funksional është pjesë përbërëse e strategjisë sonë dhe do të ketë rol agjendën tonë të reformave.

B

**CILAT DO TË JETË PËRFITIMET NGA NDRYSHIMI PËR INSTITUCIONIN?**

Ne do të përmirësojmë qasjen tonë për të monitoruar performancën tonë dhe të bëhemi të shkathët në sistemet tona të menaxhimit. Covid na ka mësuar shumë rreth fleksibilitetit dhe ne do ta përdorim këtë përvojë për të përmirësuar mënyrën se si funksionon institucioni ynë. Ne qendër ne do të fokusohemi tek prokurorët dhe stafi dhe shërbimet që ata ofrojnë.

C

**SI DO TË NDIKOJË POZITIVISHT TEK QYTETARËT?**

Qytetarët e Kosovës janë fokusi jonë kryesor. Janë dy aspekte se si qytetarët e Kosovës e gjykojnë sistemin prokurorial.

1. Si e përjetojnë ata vetë drejtësinë – Ne jemi vetëm një ndër pjesët kritike të kësaj
2. Si na perceptojnë ata përmes sjelljeve tona, Media dhe shoqëria civile – Ne duhet ti bëjmë përpjekjet tona më të dukshme

D

**SI NDIKON NË MËNYRËN SE SI PUNOJNË PROKURORËT DHE STAFI?**

Në 3 vitet e ardhshme do të reformojmë dhe ristrukturojmë administratën e prokurorisë. Kjo do të përmirësojë ndihmën për prokurorët që janë në vijën e parë të luftës kundër krimit. Për më tepër, ne do të përmirësojmë vetëdijen për lidhshipin dhe menaxhimin tek të gjithë udhëheqësit tanë aktual dhe të ardhshëm. Derisa ne i kushtojmë më shumë vëmendje të dhënave të performancës, logaridhënia do të rritet.

## METODOLOGJIA

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024 është hartuar mbi bazën e një analize të detajuar të vlerësimit të zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial për periudhën 2019-2021. Ky vlerësim ka paraqitur për secilin aktivitet të arriturat, zbatueshmerinë, sfidat dhe rekomandimet për zhvillimin e mëtutjeshëm të objektivave dhe aktiviteteve në periudhën e ardhshme.

Ky proces për hartimin e Strategjisë është udhëhequr nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe gjatë tërë kohës janë angazhuar dhe konsultuar kryeprokurorët e prokurorive, prokurorët dhe njësitë përgjegjëse të administratës së sistemit prokurorial.

Një përkrahje shumë domethënëse kanë ofruar edhe partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët përmes ekspertizave, ideve, komenteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, kanë dhënë kontributin e tyre, me qëllim të hartimit të një plani strategjik sa më profesional dhe të arritshëm. Gjithashtu, një kontribut të rëndësishëm për hartimin e tij kanë dhënë edhe përfaqësuesit e Projektit të Bashkimit Evropian, EUKOJUST dhe Projekti i Ambasadës Britanike “Fuqizimi i sistemit të drejtësisë”.

Në hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 është punuar me muaj të tërë dhe ky proces ka kaluar nëpër disa faza, si:

- *Themelimi i Grupit punues për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024*

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka vazhduar praktikën e tij me anë të themelimit të Grupit punues për hartimin e këtij plani, qëllimi i themelimit të të cilit ishte caktimi i personave përgjegjës, kompetentë dhe me përfaqësim nga të gjitha prokuroritë dhe administrata e sistemit prokurorial.

Në takimet dhe punëtoritë e përfaqësuesve të këtij grupi punues kanë marrë pjesë edhe kryeprokurorë, prokurorë dhe përfaqësues të tjerë të administratës, me qëllim të përfshirjes dhe përfaqësimit sa më të madh të të gjitha strukturave.

- *Analiza e zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021*

Pas themelimit të grupit punues, hapi i parë ishte përgatitja e raportit, përmes të të cilit është analizuar zbatimi i Planit strategjik të sistemit prokurorial për periudhën 2019-2021. Gjatë kësaj faze janë grumbulluar informata të nevojshme, të cilat pastaj janë analizuar për të vlerësuar situatën e tij. Për hartimin e këtij raporti janë përdorur raportet e brendshme të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit si dhe të dhënat që janë ofruar nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve konkrete.

Raporti për zbatimin e planit strategjik është bërë me qëllim të identifikimit të aktiviteteve të realizuara, atyre në proces dhe aktiviteteve që nuk janë realizuar dhe ky raport është përdorur si bazë për identifikimin fillestar të objektivave dhe aktiviteteve që janë të vazhdueshme dhe duhet të përfshihen edhe në planin e ri, të aktiviteteve që nuk janë përfunduar dhe duhet të barten në planin e ri si dhe aktiviteteve për të cilat është vlerësuar se nuk është e nevojshme përfshirja e tyre.

- *Tryeza pune të grupit punues së bashku me partnerët ndërkombëtarë për caktimin e objektivave strategjike*

Në tryezën e parë të punës, përveç grupit punues, pjesëmarrës ishin edhe Kryesuesi i Këshillit, Kryeprokurori i Shtetit, kryeprokurorë, përfaqësues të tjerë nga prokuroritë dhe administrata, si dhe ekspertët e Projektit EUKOJUST. Në këtë tryezë janë prezantuar të gjeturat e Raportit për zbatimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021 dhe janë diskutuar dhe vendosur shtyllat dhe objektivat strategjike për planin e ri.


Në vazhdim, Kryesuesi i Grupit punues ka mbajtur takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e Projektit EUKOJUST dhe projektit britanik, me të cilët ka zhvilluar strukturën e planit dhe analizën SWOT.

- *Hartimi i Planit strategjik*

Në këtë fazë është hartuar drafti i Planit strategjik, ku janë marrë për

bazë të gjeturat e Raportit për zbatimin e planit strategjik paraprak, diskutimet e zhvilluara gjatë tryezave të punës dhe takimeve, analiza SWOT dhe objektivat strategjike, të përcaktuara në tryezat e punës. Pas hartimit të draftit të parë është mbajtur një tryezë pune me grupin punues dhe partnerët ndërkombëtarë, ku është diskutuar drafti fillestar dhe janë bërë plotësime dhe ndryshimet e nevojshme sipas propozimeve të grupit punues dhe partnerëve ndërkombëtarë. Si pjesë e Planit strategjik është hartuar Plani i veprimit, duke përfshirë aktivitetet, treguesit, afatet kohore, buxhetin dhe njësitë përgjegjëse për zbatimin e planit.

Para miratimit në Këshill është mbajtur një forum me partnerët ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe mediat, ku janë diskutuar objektivat strategjike të sistemit prokurorial në këtë plan.



# PASQYRË E PËRGJITHSHME

## Vizioni

Një sistem prokurorial që njihet për profesionalizëm, llogaridhënie, paanshmëri dhe që ka besim të lartë të qytetarëve të Kosovës që ofrohet nga shërbimi i prokurorisë, i cili është efikas, efektiv dhe etik.

## Misioni

Misioni i sistemit prokurorial ka për qëllim që suksesshëm të parandalojë<sup>1</sup>, hetojë dhe ndjekë kryesit e veprave penale në mënyrë transparente, të pavarur dhe të paanshme me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të ofrojë mbikëqyrje, menaxhim, analiza, politika efektive dhe administrim të nivelit të duhur për të siguruar që Prokurori i Shtetit ka të gjitha burimet që i nevojiten për të ofruar një shërbime prokuroriale me performansë të lartë, llogaridhënese dhe të qasshme për qytetarët e Kosovës.

## Vlerat

Sistemi prokurorial në punën e tij do të udhëhiqet nga standarde dhe vlera të larta, si me:

- Profesionalizëm, integritet, dinjitet, etikë dhe pavarësi në punë;
- Llogaridhënie dhe transparencë;
- Qasje të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe
- Efikasitet dhe efektivitet në punë.

## Struktura

Sistemi prokurorial i Republikës së Kosovës përbëhet nga dy institucione të pavarura kushtetuese: Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit.

<sup>1</sup> Neni 8 i Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës është përcaktuar si institucion i pavarur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndërsa funksionet i realizon në bazë të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe akteve përkatëse nënligjore.

Këshilli është institucion tërësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, i cili ka këto përgjegjësi kryesore:

- i. Siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme;
- ii. Rekruton dhe propozon te Presidenti kandidatët për emërim dhe rrimërim për prokurorë, përfshirë Kryeprokurorin e Shtetit;
- iii. Zgjedhë kryeprokurorët e prokurorive të të gjitha niveleve;
- iv. Vlerëson, ngritë në detyrë, disiplinon, propozon shkarkimin, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve;
- v. Themelon standardet për zhvillimin profesional të prokurorëve, stafit administrativ dhe profesional në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe
- vi. Zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit, gjithashtu, siguron buxhetin, resurset njerëzore, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme për funksionimin e Prokurorit të Shtetit.

Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, dhjetë (10) prej të cilëve janë prokurorë, ndërsa tre (3) anëtarë joprokurorë. Me bazën aktuale ligjore Këshilli përbëhet nga:

- Kryeprokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare (ex officio);
- Shtatë (7) anëtarë prokurorë, një (1) nga çdo prokurori themelore;
- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit;

- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria Speciale;
- Një (1) anëtar avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
- Një (1) anëtar, profesor universitar i fakulteteve juridike dhe
- Një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile.

Këshilli udhëhiqet nga Kryesuesi, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve prokurorë të Këshillit, me mandat tre (3) vjeçar.

Kryesuesi i Këshillit paraqet raporte publike vjetore së paku një herë në vit për performansën, veprimet, koston dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial, si dhe organizon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve të përhershme sipas këtij ligji, duke i mundësuar Këshillit një proces transparent dhe të përgjegjshëm të propozimeve dhe emërimit të tyre.

Këshilli realizon mandatin e tij përmes punës së komisioneve të përhershme, të themeluara me ligj, të cilat janë si në vijim:

- Komisioni për Çështje Normative;
- Komisioni për Vlerësimin e Performansës së Prokurorëve;
- Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel dhe
- Komisioni për Administrimin e Prokurorive.

Për të realizuar mandatin e vet, Këshilli mund të themelojë edhe komisione të tjera të përkohshme ose të përhershme, sipas nevojës.

Këshilli ka Sekretariat, i cili ofron mbështetje administrative për Këshillin, komisionet e tij dhe prokuroritë, mbështetje kjo, që ka të bëjë kryesisht me shërbimet për buxhetin, financat, prokurimin, burimet njerëzore, logjistikën, infrastrukturën dhe teknologjinë informative. Këshilli realizon aspektet analitike, statistikore, të ngritjes profesionale të prokurorëve dhe personelit përmes Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë.



Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur, i paanshëm, i cili ka mandat dhe përgjegjësi për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale, struktura dhe kompetencat e të cilit rregullohen me ligj.

Ligji për Prokurorin e Shtetit përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e tij, që, ndër tjera, përfshijnë: ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme, të sigurohen të gjithë personat për trajtim në mënyrë të barabartë, të zbatohen standardet më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare, të ketë sjellje të ndershme dhe profesionale në jetën personale dhe profesionale, duke u bazuar në ligjet e zbatueshme dhe kodin e etikës profesionale, mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar, si dhe në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit, hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale.

Prokurori i Shtetit ka strukturën si në vijim:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me seli në Prishtinë, si instanca më e lartë e Prokurorit të Shtetit me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- Prokuroria e Apelit, e cila përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda dhe ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- Prokuroria Speciale, si organ prokurorial i specializuar, me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi, përbëhet nga Departamenti për Krime Lufte, Departamenti për Krim të Organizuar dhe Krime të Tjera në Kompetencë të PSRK-së, Departamenti për Terrorizëm dhe Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar.<sup>2</sup>
- Prokuroritë themelore përbëhen nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda.

<sup>2</sup> Të themeluara me vendime të Këshillit: KPK/nr. 141/2015 i datës 08.06.2015 dhe KPK/nr. 133/2020 i datës 21.02.2020

## Buxheti

Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për tërë sistemin prokurorial në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale, si dhe auditimin financiar.

Në kuadër të kategorive ekonomike të buxhetit të Këshillit përfshihen pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzimet kapitale.

Këshilli ka katër programe buxhetore: Prokurorët dhe Administrata, në të cilin përfshihen të gjitha shpenzimet e krijuara nga Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, Prokurorët Specialë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Njësia Kundër Krimeve Ekonomike.


Çdo vit janë bërë ndryshime në kuadër të buxhetit të Këshillit, si rrjedhojë e rishikimit të buxhetit, kërkesës për mjete shtesë, transfereve, harmonizimit brenda programeve buxhetore dhe kursimeve të deklaruara. Gjatë vitit 2020, buxheti i Këshillit ishte zvogëluar për afro 1,350,000 euro për shkak të situatës së krijuar me COVID-19 ku ishin bërë alokimet buxhetore në nivel shtetëror.

Buxheti i miratuar për vitin 2022 për Këshillin Prokurorial të Kosovës është 17,144,178 euro, i cili është buxheti më i lartë që ka pasur ndonjëherë sistemi prokurorial, por as për këtë vit nuk është miratuar plotësisht sipas kërkesave dhe nevojave tona. Në krahasim me vitet paraprake, në vitin 2022 ka pasur rritje në kategoritë “Paga dhe mëditje” dhe “Investime kapitale”, ku në këtë të fundit planifikohen ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike të sistemit prokurorial. Po ashtu, planifikohet vazhdimi i investimeve në blerjen e mjeteve të transportit, në sisteme elektronike, si në: menaxhimin e lëndëve, menaxhimin të veturave, të buxhetit, menaxhimin e rasteve për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave, të menaxhimet të takimeve, etj.

Në vazhdimësi, realizimi i buxhetit ka qenë afro 100%.

	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Buxheti fillestar</b>	11,092,826	14,170,065	15,021,836	14,441,527.61	17,144,178
<b>Buxheti përfundimtar</b>	12,535,110.03	14,018,592	13,672,561	13,536,237.34	
<b>Realizimi</b>	12,234,268.10	13,714,892	13,299,066	13,324,453.91	
<b>Realizimi në %</b>	97.60%	97.83%	97.27%	98.4%	

Tabela 1: Buxheti i Këshillit ndër vite dhe realizimi i tij



Grafikoni 1: Buxheti i Këshillit ndër vite dhe realizimi i tij

Përveç kësaj, sistemi prokurorial i Kosovës mbështetet në vazhdimësi nga partnerët ndërkombëtarë. Përkrahja e tyre ka qenë në forma të ndryshme përmes projekteve, donacioneve, asistencës teknike, zhvillimit profesional, etj. Objektivat e paraqitura në Planin strategjik përfshijnë procese në të cilat ka pasur angazhim të palodhshëm nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, Ambasada e Britanisë së Madhe, Zyra e BE-së në Kosovë, Qeveria e Norvegjisë, Holandës, UNDP-ja, GIZ-i, OSBE-ja, EULEX-i, etj.

Gjatë hartimit të këtij plani, krahas fokusit në përcaktimin e objektivave të arritshme dhe të matshme, përcaktimin e veprimeve për arritjen e tyre, një vëmendje e veçantë iu ka kushtuar edhe planifikimit buxhetor për realizimin e objektivave kryesore të sistemit prokurorial.

Këshilli, si çdo herë do të hartojë edhe dokumentet financiare, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, buxheti vjetor dhe planifikimet për tre vjetët e ardhshëm, si dhe do të bëhet rishikimi i planifikimeve buxhetore për linja dhe kode të caktuara buxhetore në përshtatje me planin strategjik.

## Zhvillimi institucional

Gjatë periudhës 2019-2021 ka pasur ndryshime në aktet ligjore që rregullojnë funksionimin e sistemit prokurorial. Është miratuar Ligji i ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Me hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve dhe ndryshimeve të tjera brenda sistemit prokurorial janë miratuar edhe aktet përkatëse nënligjore, si dhe janë përcaktuar politikat dhe udhëzimet në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi. Një ndër ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën e Këshillit është shuarja e Komisionit Disiplinor, si komisioni i përhershëm, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, që është reflektuar edhe në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

## *Pandemia COVID-19*

Gjatë kësaj periudhe, edhe sistemi prokurorial është ballafaquar me pasojat nga pandemia COVID-19. Reduktimi i aktiviteteve në ato esenciale, reduktimi i stafit, reduktimi i buxhetit, rastet me infektim të punonjësve me COVID dhe vdekjet e shkaktuara nga ky virus, kanë qenë vetëm disa nga sfidat, me të cilat jemi ballafaquar si sistem.

Në këtë drejtim, KPK-ja dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, në bashkëpunim me Projektin britanik kanë hartuar Planin e veprimit për menaxhimin e krizave, duke pasur parasysh domosdoshmërinë e vazhdimësisë së punës, duke krijuar plan efektiv në mënyrë që të mundësohet ofrimi i shërbimeve thelbësore gjatë pandemisë. Si rezultat, të gjitha prokuroritë e Kosovës kanë themeluar ekipet rajonale për menaxhimin e krizave, të cilët mbajnë takime të rregullta dhe raportojnë në KPK në baza javore sa u përket masave të ndërmarra me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së punës.

## *Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me Aktgjykimin nr. ref.:AGJ 1583/20, të datës 9 korrik 2020, ka konstatuar pavarësinë e administratës së sistemit prokurorial në raport me Ekzekutivin.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se nëpunësit civilë të sistemit prokurorial janë nëpunës civilë me status të veçantë për arsye se parimi i ndarjes së pushtetit është i garantuar me nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës dhe pavarësia e sistemit prokurorial është e garantuar me nenet 109 dhe 110 të Kushtetutës.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se institucionet e pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm, duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata, theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për atë që ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Rregullimet të cilat krijojnë “ndërhyrje” të drejtpërdrejtë në pavarësinë funksionale dhe organizative të tyre janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parimet e vlerat e proklamuar aty.

Me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është obliguar Kuvendi i Kosovës që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë në mënyrë që të njehë të drejtën e KPK-së për nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të brendshme, sa i përket çështjeve të strukturës organizative të funksionimit, klasifikimit të pozitive, kushteve të veçanta për rekrutim, orarit të punës dhe të drejtave dhe detyrimeve specifike, të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë, në mënyrë analoge siç parashihet për nëpunësit e Kuvendit, ku Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar çështje të caktuara të nëpunësve të saj civilë.

Për më tepër, në përgjigje të kërkesës së Këshillit për sqarim, Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar Këshillin se, institucionet për të cilat, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk do të zbatohet Ligji për Zyrtarët Publikë, në këtë rast, Këshilli Prokurorial të Kosovës dhe Prokurori i Shtetit, do të vlerësojnë vetë për mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore në pajtim me këtë Aktgjykim.

## *Rishikimi funksional*

Procesi i Rishikimit Funksional dhe hartimi i Strategjisë janë iniciuar lidhur me nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të sektorit, për të adresuar problemet ligjore dhe ato praktike, të evidentuara nga institucionet shtetërore, raportet ndërkombëtare, shoqëria civile, por edhe nga qytetarët.

Duke marrë parasysh se korniza ligjore dhe ajo institucionale e sektorit të sundimit të ligjit është avancuar në mënyrë të konsiderueshme, është kuptuar se shkak kryesor, ose më i shpeshtë, për ngecjet në konsolidimin e plotë të sistemit ka të bëjë me zbatimin jo të duhur të legjislacionit. Si rrjedhojë, edhe veprimet për reformimin e sistemit janë të drejtuara kryesisht në këtë aspekt. Mirëpo, kjo nuk përjashton ndryshimet e nevojshme legislative dhe të praktikave aktuale institucionale.

Konsiderojmë se procesi i Rishikimit Funksional është njëri ndër proceset me një rëndësi mjaft të madhe për sistemin e drejtësisë. Janë mbajtur vazhdimisht takime me Ministrinë e Drejtësisë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, në lidhje me Rishikimin Funksional për adresimin dhe kontrollimin e aktiviteteve, të cilat janë realizuar nga sistemi prokurorial.

Është konstatuar se sistemi prokurorial ka avancuar në aspektin e legjislacionit primar dhe në atë sekondar, në miratimin e rregulloreve të nevojshme, në avancimin e profesionalizimit, disiplinimin e prokurorëve, llogaridhënien dhe hartimin e strategjive të nevojshme.

Rishikimi Funksional është ndarë në katër kapituj dhe sistemi prokurorial është prekur në forma të ndryshme në të gjithë këta kapituj.

Bazuar në këtë proces është hartuar Strategjia për sundimin e ligjit, ku Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, si dy nga aktorë të përfshirë në këtë proces, kanë ofruar kontributin e tyre në kapitujt që kanë të bëjnë me sistemin prokurorial. Rrjedhimisht, edhe hartimi i Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 është bazuar në aktivitetet dhe obligimet që dalin nga Strategjia për sundimin e ligjit, realizimi i të cilave do të monitorohet dhe raportohet në baza të rregullta nga

mekanizmat e sistemit prokurorial.

Ndër vite, sistemi prokurorial i Kosovës ka pasur strategji të ndryshme në fuqi, të cilat kanë paraparë objektivat për aspekte të ndryshme të fushëveprimtarisë së sistemit, si:

- Planin strategjik për bashkëpunim ndërinstitucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit 2013-2015;
- Plani strategjik të TIK-ut <sup>3</sup>2015-2020;
- Plani strategjik 2016-2018;
- Plan strategjik (2016-2018) dhe Planin e veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme;
- Strategjinë e komunikimit me publikun e sistemit prokurorial 2018-2020;
- Strategjinë e krimeve të luftës;
- Planin strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021 dhe
- Strategjinë për komunikim publik të sistemit prokurorial 2021-2023

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2019-2021, i miratuar nga Këshilli, paraqet vizionin e sistemit prokurorial që bazohet në rishikimin e situatës aktuale dhe nevojave për avancimin e mëtejshëm të sistemit në përputhje me zhvillimet përbrenda sistemit prokurorial dhe zhvillimeve në institucionet e tjera shtetërore. Plani ka marrë parasysh edhe dokumentet dhe raportet e dala nga mekanizmat ndërkombëtarë që monitorojnë dhe mbështesin sistemin prokurorial.

Ky plan ka qenë bazë për hartimin e planeve vjetore të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, planeve dhe strategjive të tjera që janë hartuar gjatë këtyre tre vjetëve.

<sup>3</sup> Teknologjia Informative e Komunikimit



Plani strategjik i sistemit prokurorial 2019-2021 ishte ndarë në katër shtylla, 26 objektiva dhe 166 aktivitete, që përfshijnë Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit.

### **Shtylla I: Fuqizimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial**

Gjatë periudhës që ka mbuluar Plani, Këshilli ka arritur fuqizimin e kornizës nënligjore dhe ka punuar në strukturën organizative. Në këtë drejtim, gjatë periudhës trevjeçare janë miratuar 16 rregullore, tri udhëzime administrative dhe janë marrë 585 vendime.

Në zbatim të ndryshimeve ligjore dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës së Këshillit dhe trupave të tij, kanë filluar punën me orar të plotë në Këshill, përveç Kryesuesit, edhe Zëvendëskryesuesi dhe kryetarët e Komisioneve për Vlerësim të Performansës së Prokurorëve, Administrim të Prokurorive dhe Komisionit për Çështje Normative, të cilët kanë pezulluar detyrën e prokurorit. Për më tepër, janë zgjedhur anëtarët e rinj të Këshillit, pas skadimit të mandatit të anëtarëve paraprakë, si dhe Kryesuesi i ri i Këshillit. Janë përzgjedhur dhe emëruar kryeprokurorët e rinj të Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale dhe prokurorive themelore.

Në drejtim të llogaridhënies sistematike, Këshilli ka miratuar mekanizimin për raportimin e kryeprokurorëve, të cilët në baza të rregullta kanë raportuar fizikisht dhe me shkrim në takimet e Këshillit. Po ashtu, raportim i rregullt është bërë edhe nga komisionet e përhershme të Këshillit dhe ato ad hoc.

Transparenca dhe komunikimi me publikun ka qenë një ndër objektivat kryesorë të sistemit prokurorial dhe në këtë aspekt ka pasur zhvillime të dukshme gjatë këtij trevjeçareshi. Në këtë drejtim, është krijuar uebfaqja unike e sistemit prokurorial, ku përfshihen Këshilli dhe Prokurori i Shtetit në një portal të vetëm, që ka mundësuar qasje më të lehtë në informata nga palët e interesuara për këto dy institucione. Në këtë portal janë publikuar në baza të rregullta statistika të lëndëve dhe raporte përmbledhëse të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit dhe, krahas kësaj, janë ofruar edhe të dhëna statistikore dhe informata të tjera për të gjitha palët që kanë bërë kërkesa të tilla.



Komunikimi me publikun është lehtësuar dhe avancuar në masë të madhe me rekrutimin dhe fillimin e punës së zyrtarëve për informim dhe monitorim të mediave në secilën prokurori të Republikës së Kosovës.

Një praktikë e re, që ka mbajtur publikun të informuar në baza ditore, është edhe publikimi i Raportit 24-orësh lidhur me veprimet e prokurorive për 24 orë sa i përket rasteve penale si: ndalimet me vendim të prokurorit, paraburgimet, sekuestrimet dhe kontrollet, aktakuzat, me theks të veçantë ato që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Për më tepër ka filluar publikimi i statistikave të rasteve disiplinore dhe vlerësimit të performansës, me qëllim të ngritjes së transparencës së këtyre proceseve. Publikimi i tyre do të vazhdojë në baza të rregullta për ta mbajtur të njoftuar publikun.

Të gjitha prokuroritë e Kosovës kanë mbajtur takime të rregullta me qytetarët, të cilat janë realizuar një ditë brenda javës. Janë mbajtur konferenca vjetore të prokurorëve, ku janë prezantuar të arriturat kryesore të Prokurorit të Shtetit, konferenca vjetore për media të Kryesuesit të Këshillit dhe konferenca vjetore për mbrojtje dhe ndihmë viktimave. Varësisht nga rastet specifike janë mbajtur edhe konferenca të tjera ad hoc të Prokurorit të Shtetit.

Gjatë kësaj periudhe, me qëllim të avancimit të komunikimit me publikun janë hartuar dhe miratuar disa dokumente mjaft të rëndësishme, siç janë: Protokollin për media i sistemit prokurorial, Udhëzuesi dhe manuali për komunikim në kriza të sistemit prokurorial dhe Strategjia për komunikim me publikun 2021-2023.

Me qëllim të lehtësimit të kryerjes së aktiviteteve në punë është bërë digjitalizimi i proceseve të punës dhe është implementuar sistemi e-arkiva, që mundëson arkivimin dhe asgjësimin e dokumenteve dhe gjenerimin e raporteve. Gjithashtu është funksionalizuar databaza për dosjen e prokurorëve dhe ka filluar zbatimi i sistemit elektronik për aplikim për prokurorë të rinj.

Sa i përket Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve (SMIL), i cili aplikohet në të gjitha prokuroritë themelore dhe në Prokurorinë Speciale, së shpejti do të fillojë edhe në Zyrën e Kryeprokurorit të

Shtetit. Shpërndarja e lëndëve bëhet përmes sistemit në mënyrë automatike dhe ka filluar pilotprojekti i zëvendësimit të regjistrave fizikë me ata elektronikë.

Bashkëpunimi i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare është rregulluar me ligj dhe akte nënligjore. Këshilli ka vazhduar politikën e bashkëpunimit të hapur dhe profesional me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Ndër institucionet vendore vlen të veçohen: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Akademia e Drejtësisë, Kuvendi, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Oda e Avokatëve, Avokati i Popullit, Policia e Kosovës dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit.

Vend të veçantë në fushën e bashkëpunimit kanë donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, si: Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e BE-së në Prishtinë, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, Ambasada e Norvegjisë, Ambasada e Holandës dhe ambasadat e tjera, UNDP-ja dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, EULEX-i, Këshilli i Evropës, Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), GIZ-i dhe institucione e organizata të tjera. Ky bashkëpunim ka qenë një ndër shtyllat kryesore për fuqizimin e kapaciteteve prokuroriale dhe përmirësimin e proceseve të punës që është realizuar përmes takimeve koordinuese me donatorë, marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve, trajnimeve, financimit të projekteve kapitale, vizitave studimore, programeve për shkëmbim të përvojave, etj.

Një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit është shprehur edhe në proceset e integritimit evropian, ku të gjitha kapacitetet e Këshillit janë përgjigjur në çdo kohë në kërkesat për raportim dhe janë bërë përgatitjet e projektpropozimeve të ndryshme për financim të projekteve.

Përgjatë viteve, Këshilli është ballafaquar me sfida të shumta për rekrutimin e stafit profesional dhe administrativ, ngaqë çdo pozitë e re apo konkurs duhej të miratohej nga Ministria e Administratës Publike, gjë që në disa raste shkaktonte vonesa dhe pengesa në pavarësinë e vendimmarrjes së Këshillit.

Një zhvillim mjaft i rëndësishëm ka ndodhur gjatë kësaj periudhe ku, sa i përket statusit të administratës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin nr. ref.:AGJ 1583/20, të datës 9 korrik

2020, ka konstatuar pavarësinë e administratës së sistemit prokurorial në raport me Ekzekutivin.

Me qëllim të plotësimit të nevojave të prokurorive me resurse njerëzore, Këshilli gjatë periudhës trevjeçare ka rekrutuar 166 zyrtarë të rinj në tërë sistemin prokurorial, prej tyre 44 zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesionalë dhe 52 zyrtarë ligjorë, të cilët ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për prokurorët e shtetit.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të shërbimit dhe llogaridhënies së administratës së sistemit prokurorial ka filluar procesi i riorganizimit dhe ristrukturimit të së njëjtës, proces ky, i cili pritet të përfundojë gjatë vitit 2022.

## **Shtylla II: Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të sistemit prokurorial**

Në mënyrë që sistemi prokurorial të ketë besimin e publikut është jetike që prokurorët dhe personeli mbështetës të jenë profesionalë dhe të respektojnë normat etike, si dhe të zbatojnë mandatin ligjor në mënyrë të pavarur dhe të paanshme ndaj të gjithë shkelësve të ligjit pa dallim.

Periudha trevjeçare që mbulon ky plan strategjik ka pasur zhvillime mjaft domethënëse sa i përket fuqizimit të llogaridhënies dhe integritetit në sistemin prokurorial.

Është reformuar sistemi i disiplinimit të prokurorëve, me ç'rast me miratimin e Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Këshilli ka miratuar rregulloren përkatëse dhe procedurat disiplinore janë zhvilluar përkitazi me legjislacionin e ri në fuqi. Procedurat tashmë nuk zhvillohen nga një komision i vetëm, por nga panele që themelohen ad hoc përmes shortit.

Përveç kësaj, gjatë kësaj periudhe, Këshilli ka miratuar Kodin e etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve dhe hartoi e publikoi Komentarin e këtij Kodi.

Gjatë periudhës 2016-2018, kur procedurat disiplinore zhvilloheshin me ligjin e vjetër dhe Kodi i ri i Etikës nuk ishte ende në fuqi, u morën 40 vendime disiplinore ndaj prokurorëve. Ndërsa, në periudhën 2019-2021 janë marrë 25 vendime disiplinore ndaj prokurorëve. Këshilli

Prokurorial i Kosovës, sidomos pas ndryshimeve të fundit ligjore lidhur me procedurat disiplinore ndaj prokurorëve, ka propozuar prokurorë për shkarkim, ka suspenduar prokurorë, ka ulur në detyrë, ka bërë zvogëlim të pagës dhe ka shqiptuar vërejtje jopublike me shkrim, etj.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është angazhuar maksimalisht në rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve. Hapi i parë në arritjen e këtij qëllimi ka qenë rekrutimi i numrit të nevojshëm të prokurorëve. Si rezultat, KPK-ja, nga viti 2011, ku ka pasur 92 prokurorë në sistemin prokurorial, ka arritur që në vitin 2019 ta rrisë numrin e prokurorëve në 197. Për arsye të pensionimeve dhe vdekjeve të disa prokurorëve, ky numër në vitin 2020 ka qenë 191, ndërsa në fund të vitit 2021 ishte 182. Mirëpo, në maj 2021, KPK-ja ka shpallur konkurs për rekrutimin e 16 prokurorëve të rinj për të plotësuar pozitat vakante.

Nëse merret për bazë rekrutimi i prokurorëve që nga viti 2011, del në pah se janë rekrutuar 151 prokurorë, që, në përqindje, del që janë 80% prokurorë të rinj me eksperiencë më pak sesa 10 vjet në sistemin prokurorial.

Viti	Numri i prokurorëve në total dhe të rekrutuar ndër vite (për çdo vit) që nga themelimi i KPK-së	
	Gjithsej prokurorë	Prej tyre, janë të rekrutuar gjatë vitit përkatës
2011	92	8
2012	125	38
2013	123	0
2014	139	21
2015	149	13
2016	171	25
2017	177	13
2018	191	21
2019	197	12
2020	191	0
2021	182 <sup>4</sup>	0 <sup>5</sup>

*Tabela 2: Numri i prokurorëve në total dhe të rekrutuar ndër vite (për çdo vit) që nga themelimi i KPK-së*

4 Mospërputhja mes numrit të prokurorëve të rekrutuar dhe numrit total të prokurorëve ka ndodhur për faktin se gjatë vitit ka pasur raste kur disa prokurorëve iu ka pushuar funksioni për shkak të ndonjë rrethane të përcaktuara me ligj.

5 Procesi për rekrutimin e 16 prokurorëve të rinj ka filluar në 2021 dhe janë mbajtur testi kualifikues dhe testi me shkrim, mirëpo procesi në tërësi do të përfundojë në vitin 2022.

Me qëllim të fuqizimit të procesit të vlerësimit të performansës së prokurorëve, KPK-ja në vitin 2020 ka ndryshuar rregulloren, e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2021. Kjo rregullore ka adresuar sfidat të cilat janë paraqitur ndër vite. Për më tepër në këtë rregullore:

- janë paraparë vlerësimi jo i rregullt;
- janë përcaktuar qartë indikatorët për vlerësimin e performansës;
- është qartësuar rëndësia e vlerësimit të tyre;
- është avancuar vlerësimi i prokurorëve nga eprori dhe
- janë pasqyruar efektet e vlerësimit.

Një ndër sfidat gjatë procesit të vlerësimit ka qenë angazhimi i anëtarëve të Komisionit me punë të përhershme si prokurorë dhe angazhimit shtesë në Komision, i cili kërkon përkushtim dhe kohë për të arritur në një proces efikas dhe sa më të saktë.

Gjatë këtyre tre vjetëve janë vlerësuar 206 prokurorë. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka marrë vendime për të dërguar prokurorët në trajnim të detyrueshëm, të cilët kanë treguar rezultate të pamjaftueshme në performansën e tyre, me theks të veçantë në profesionalizëm. Në këtë drejtim, me qëllim të adresimit të performansës së pamjaftueshme, të dokumentuar me vlerësim të performansës, KPK-ja ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Akademinë e Drejtësisë për trajnimet e detyrueshme dhe trajnimet shtesë për prokurorë. Për më tepër, përmes protokolleve të përbashkëta janë përcaktuar procedurat për realizimin e këtyre trajnimeve. Ndaj vlerësimit të performansës përgjatë këtyre tre vjetëve, Këshilli, si shkallë e dytë, ka pranuar 67 kundërshtime të prokurorëve ndaj vlerësimit të performansës së tyre, të bërë nga Komisioni. Nga këto, Këshilli ka miratuar 24 kundërshtime dhe ka obliguar Komisionin që të bëjë rivlerësimin e këtyre prokurorëve.

Në drejtim të avancimit të sistemit për zhvillim në karrierë, gjatë vitit 2021, Këshilli ka miratuar Rregulloren e re për transferimin dhe avancimin e prokurorëve. Po ashtu, me qëllim të plotësimit të nevojave të prokurorëve, si rezultat i ngarkesës me lëndë, Këshilli gjatë këtyre tre vjetëve ka avancuar 33 prokurorë.

Për çdo vit Këshilli miraton dokumentin për politikat e trajnimit për prokurorët dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial. Ky dokument përfshin vlerësimin e nevojave për trajnim për prokurorët dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial, i cili përcakton kornizat, brenda të cilave Akademia e Drejtësisë dhe institucionet e tjera përkatëse do të mund të dizajnojnë programet e tyre trajnuese.

Përmes procesit të vlerësimit të nevojave për trajnim, Këshilli synon të përmirësojë performansën në punë dhe të ngritë profesionalizmin e prokurorëve dhe personelit. Si fokus i dokumentit të politikave të trajnimit në vazhdimësi kanë qenë temat, por jo vetëm si: hetimet financiare në rastet e korrupsionit, krimet të organizuar, krimet e luftës, sekuestrimi, ngrirja dhe konfiskimi i pasurisë, veprat që ndërlidhen me narkotikë, shkeljet e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe penale në praktikën gjyqësore, siguria kibernetike, abuzimi i fëmijëve, komunikimi me media dhe publikun, krimet e urrejtjes dhe ndërmjetësimi.

152 prokurorë kanë marrë pjesë në trajnime në vitin 2019, kurse në vitin 2020 në total në trajnime kanë marrë pjesë 163 prokurorë, ndërsa në vitin 2021 kanë marrë pjesë 137 prokurorë.

Po ashtu, trajnime në vazhdimësi janë organizuar dhe nga partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë.

**Shtylla III: Hetimi dhe ndjekja e kryesve të veprave penale, që reflekton profesionalizëm, përkushtim, efikasitet dhe respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut përmes zbatimit të standardeve më të larta profesionale dhe etike**

Sistemi prokurorial, konkretisht, Prokurori i Shtetit, në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor për ndjekjen e kryesve të veprave penale, me përkushtim maksimal tenton në çdo fazë të procedurës penale të shpërfaqë dhe të dëshmojë profesionalizëm. Profesionalizimi i tillë dëshmohet në kryerjen e detyrave në mënyrë efikase, duke mos dëmtuar proceset dhe duke vepruar në bazë të afateve ligjore.

Në drejtim të kësaj, Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë, i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, është menduar të jetë një zotim për profesionalizëm dhe jo një plan për ndëshkim. Kodi, po ashtu, shërben si një njohje e përgjegjësisë së madhe që e shoqëron shërbimin publik në sistemin prokurorial të Kosovës. Respektimi i Kodit të etikës

është demonstrim i nivelit më të lartë të profesionalizmit, duke u bazuar në vlerat dhe parimet, si: pavarësia, paanshmëria, integriteti, llogaridhënia, transparenca dhe profesionalizmi i Prokurorit të Shtetit.

Kryeprokurori i Shtetit, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe profesionalizmit të punës së prokurorëve, ka nxjerrë udhëzime nga fushë veprimtari të ndryshme, si: Udhëzimi për trajtimin e krimeve të urrejtjes, për shkatërrimin e të dhënave të siguruara përmes përgjimit të ligjshëm gjatë hetimeve, për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, për zbatimin, monitorimin, raportimin dhe publikimin e aktiviteteve të Prokurorit të Shtetit, për negocimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, për trajtimin e kallëzimeve penale dhe parashtesave ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve, për dorëzimpranimin e lëndëve në rast të suspendimit – pezullimit nga detyra, për mosdërgim në ndërmjetësim të rasteve të dhunës në familje dhe Udhëzimi për harmonizim të praktikave për kualifikimin juridik të veprës penale “Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit” dhe për rolin e prokurorit në matjen e dënimit, sekuestrimit dhe konfiskimit.

Me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë janë aprovuar Procedurat standarde të veprimit mes Kryeprokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës.

Kryeprokurori i Shtetit atëherë kur është parashtruar nevoja me qëllim të rritjes së efikasitetit ka marrë vendime për transferim të përkohshëm të prokurorëve nëpër prokurori të caktuara, me ç’rast ka marrë 23 vendime në zbatim të mandatit të tij.


Po ashtu, Kryeprokurori i Shtetit ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme për bashkëpunim në fushën penale ndërmjet Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të Republikës së Shqipërisë (SPAK), Memorandum të Bashkëpunimit me Administratën Tatimore të Kosovës, Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Kryeprokurorit të Shtetit dhe Institutit të Bazelit për Qeverisje, Procedurat standarde të veprimit për zgjedhje të jashtëzakonshme mes Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës.

Koordinimi i punës së prokurorëve ka qenë në vazhden e aktiviteteve kryesore, ku janë mbajtur disa kolegji të kryeprokurorëve, varësisht nga kushtet e krijuara me pandeminë COVID-19 në prani fizike apo edhe përmes platformave online.



Për të siguruar mbarëvajtje sa më të mirë të procesit të zgjedhjeve ka vazhduar projekti strategjik "Mbrojtja e votës", nën udhëheqjen e Koordinatorës Nationale të Zgjedhjeve, e cila është nga radhët e prokurorëve të ZKPSH-së.

Një ndër objektivat kryesore në mandatin e Prokurorit të Shtetit është përmirësimi i efikasitetit në trajtimin e lëndëve. Siç mund të vërehet nga grafikoni i mëposhtëm, numri i lëndëve të bartura në vitet 2019-2021 është zvogëluar për secilin vit, ku nga 111,340 lëndë sa ishin bartur në vitin 2019 nga viti 2018, në vitin 2021 janë bartur 80,396 lëndë apo 28% më pak lëndë të bartura. Ky sukses i atribuohet punës së palodhshme të prokurorëve në zgjidhjen e rasteve ku nga grafikoni mund të vërehet se përqindja e numrit të rasteve të zgjidhura në raport me numrin e rasteve të pranuar është më shumë sesa 100% për vitet 2019 dhe 2020 dhe afro 100 % në vitin 2021.



Grafikoni 2: Trajtimi i lëndëve në periudhën 2019-2021

Ndër prioritetet e sistemit prokurorial ka qenë edhe zvogëlimi i ngarkesës me lëndë për prokurorë. Në këtë drejtim, përgjatë viteve janë rekrutuar një numër i konsiderueshëm i tyre, duke u bazuar në nevojat e prokurorëve dhe trendet e ngarkesës me lëndë. Siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme, derisa në vitin 2013, ngarkesa me lëndë për një prokurorë ka qenë 394.5, ndërsa prej tyre janë zgjidhur 278.29 lëndë për prokurorë, në vitin 2020




ngarkesa me lëndë ka qenë 157.81 për prokurorë, ndërsa zgjidhja e këtyre lëndëve ka qenë 177.10 lëndë për prokurorë. Pra, siç vërehet ngarkesa me lëndë është zvogëluar për 60%.

Ngarkesa e prokurorive me lëndë dhe efikasiteti në zgjidhjen e tyre ndër vite													
		Rastet e pranuar				Rastet e zgjidhura				Numri i prokurorëve	Ngarkesa e prokurorëve me lëndë		Pushimi i procedurës për shkak të parashkrimit
		PP	PFM	PPN	Totali	PP	PPM	PPN	Totali			Lëndët e zgjidhura për prokuror	
1	2013	26397	1730	20396	48523	21446	1426	11358	34230	123	394.5	278.29	55
2	2014	27556	1751	8261	37568	21568	1581	5693	28842	139	270.27	207.5	175
3	2015	25412	1795	9810	37017	25183	1689	7878	34750	149	248.44	233.22	8
4	2016	25227	1857	10652	37736	28465	2215	7978	38658	171	220.68	226.07	8
5	2017	24912	2073	12369	39354	33510	2821	12002	48333	177	222.34	273.07	3
6	2018	27484	2540	11987	42011	30478	2746	17027	50251	191	219.95	263.09	10
7	2019	24540	2027	10321	36888	26479	2141	15603	44223	197	187.25	224.48	10
8	2020	21650	1356	6977	29983	23027	1290	9332	33649	190	157.80	177.1	18
9	2021	23487	1749	9560	34796	23319	1986	9642	34947	183	190.14	190.97	11

Rastet e zgjidhura të prezantuara në tabelë janë rastet e llogaritura nga të dhënat: Rastet gjithsej në punë duke zbritur rastet e ngelura si të pazgjidhura, të konstatuara nga regjistrat

Tabela 2: Menaxhimi lëndëve, ngarkesa e prokurorëve me lëndë dhe parashkrimi ndër vite


Suksesi i Prokurorit të Shtetit pasqyrohet më së miri në mënyrën se si trajtohen aktet akuzuese të tyre me vendim përfundimtar në Gjykatë. Në këtë drejtim, në tre vjetët që mbulon kjo strategji, vendimet fajësuese të gjykatave përkritazi me aktet akuzuese të prokurorëve janë në përqindje shumë të lartë, gjë që dëshmon se akuzat janë të sakta, të arsyetuara, përmbajtjesore dhe jo vetëm të pranueshme nga gjykata, por edhe të konfirmuara me vendime përfundimtare fajësuese.



Grafikoni 3: Vendimet e gjykatave në total dhe vendimet fajësuese përkritazi me aktet akuzuese të prokurorëve

Prokurori i Shtetit, duke ofruar drejtësi të shpejtë përmes përgatitjes së rasteve në kohë dhe aplikimit efikas të procedurave alternative dhe procedurave të tjera (ndërmjetësim, marrëveshje për pranimin e fajësisë), gjatë periudhës së mbulimit të planit në vitin 2019 ka zgjidhur 2,401 raste, kurse gjatë vitit 2020 ka zgjidhur 1,772 raste, ndërsa gjatë vitit 2021 ka zgjidhur 2,153 raste, duke aplikuar këto procedura. Trajtimi i barabartë i palëve, duke respektuar standardet dhe parimet më të larta ndërkombëtare, është synim i qartë i punës së Prokurorit të Shtetit. Prokuroritë, përmes referimit të rasteve në procedura alternative, kontribuojnë edhe në buxhetin e Republikës së Kosovës, gjegjësisht, në Programin për kompensimin e viktimave të krimit, në dobi të fondeve për këtë kategori.

Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale është vazhdimësi e punës së Prokurorit të Shtetit, ku në këtë drejtim është nxjerrë Udhëzimi për kërkesat për konfiskim, ku, si rezultat, janë caktuar koordinatorët për konfiskim të pasurisë në çdo prokurori. Po ashtu, aplikimi i Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale është i domosdoshëm, me ç'rast është kërkuar angazhim më i madh dhe më proaktiv i kryeprokurorëve dhe prokurorëve, që, krahas ngritjes së akteve akuzuese, të gjurmohet dhe identifikohet edhe pasuria që dyshohet të jetë fituar me anë të veprave penale. Ndërsa sa i përket vlerës së aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, nga grafikoni i mëposhtëm vërehet se nga viti 2019 gjer më 2021 ka ngritje të aseteve të sekuestruara, për të cilat është kompetente prokuroria.



Grafikoni 5: Vlera e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara 2019-2021

#### **Shtylla IV: Prioritetizimi i hetimit të veprave penale dhe ndjekjes së kryesve të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ekonomike, pastrimit të parave, krimeve të luftës, terrorizmit dhe krimit kibernetik, dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes**

Prioritetizimi i veprave penale është një ndër segmentet kyçe në punën e Prokurorit të Shtetit. Ky prioritetizim ka sjellë rritjen e efikasitetit në shkallë të madhe të veprave më specifike. Specializimi dhe avancimi i veçantë në këto vepra sjellë rezultat të prekshëm dhe të pamohueshëm.

Këshilli Prokurorial, në vitin 2020, në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka themeluar tre departamente, si: Departamentin për Terrorizëm, Departamenti për Krim të Organizuar dhe Krime të Tjera në Kompetencë të PSRK-së dhe Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar.

Shenjëstrimi i rasteve nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka vazhduar të ketë një ndikim të madh, ku që nga viti 2019 gjer në vitin 2021 janë shënjestruar 79 raste të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar, prej tyre 68 raste janë me aktakuza dhe 31 raste janë të plotfuqishme.

Po ashtu, krimet e luftës janë trajtuar më prioritet të lartë, me ç'rast krahas themelimit të Departamentit për Krime të Luftës në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në vitin 2019, Këshilli Prokurorial ka miratuar Strategjinë për Krime të Luftës, qëllimi i së cilës është ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale, duke paraparë themelimin e dy mekanizmave, siç janë: Taskforca, e cila merret me përpunimin e analizës së resurseve dhe Trupi monitorues i Strategjisë së krimeve të luftës. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në trajtimin e këtyre rasteve dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, për çdo regjion të Republikës së Kosovës janë caktuar prokurorët dhe policët përgjegjës.

Në funksion të rritjes së efikasitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, Këshilli ka vazhduar të mbështesë Njësitin për Luftimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, përmes sigurimit të kushteve adekuate për punë. Me qëllim të monitorimit të rezultateve të punës, Këshilli ka themeluar një Komision Mbikëqyrës i cili ka mbikëqyrur punën e këtij

njësitë dhe punën e të gjitha prokurorive në baza të rregullta dhe ka raportuar në Këshill duke dhënë rekomandime në trajtimin e këtyre lëndëve.

Pas miratimit të Procedurave standarde të veprimit për ngritjen e efikasitetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, caktimi i koordinatorëve nëpër prokuroritë themelore ka shënuar një rezultat shumë të kënaqshëm, duke i dhënë prioritet rasteve të dhunës në familje, ku synimi kryesor është ngritja e efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve gjatë procedimit në prokurori. Specializimi i prokurorëve në fushën e dhunës në familje ua ka mundësuar prokurorëve një qasje më gjithëpërfshirëse dhe më të koordinuar për të rritur gjasat e ndjekjeve të suksesshme dhe duke mundësuar dhënien e ndihmës për viktimat dhe sigurimin e llogaridhënies së kryerësve të këtyre veprave penale.

Mbrojtja e viktimave dhe trajtimi i tyre në procedurë në mënyrë sa më adekuate ka qenë një ndër angazhimet kryesore të punës së Prokurorit të Shtetit, ku Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ka vazhduar mandatin e ofrimit e shërbimeve për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqësimin e interesave të tyre në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Gjithashtu, çdo vit është organizuar “Java për të Drejtat e Viktimave të Krimit” nën patronatin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Po ashtu, në kuadër të Prokurorit të Shtetit janë të caktuar edhe koordinatorët nacionalë kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe koordinatorë nacionalë për krime të urrejtjes.

## Analiza SWOT

Në drejtim të identifikimit sa më të saktë të fushave kryesore të fokusit të sistemit prokurorial për periudhën në vazhdim, është analizuar dhe vlerësuar pozicioni aktual i Këshilli dhe Prokurorit të Shtetit. Ky vlerësim është bërë duke përdorur metodologjinë SWOT<sup>6</sup>, e cila mundëson identifikimin e aspekteve të brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në funksionimin e institucionet. Aspektet e brendshme që varen dhe ndodhin brenda institucionit janë fuqitë dhe dobësitë, ndërsa aspektet e jashtme që nuk varen nga institucioni janë mundësitë dhe kërcënimet apo rreziqet.

<sup>6</sup> Analiza SWOT (Strengths – fuqitë; Weaknesses – dobësitë; Opportunities – mundësitë; Threats – Kërcënimet apo rreziqet).

Këto aspekte janë identifikuar përmes analizës së zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021 dhe situata të tjera, që janë krijuar gjatë kësaj periudhe dhe kanë ndikuar në sistemin prokurorial.



FUQITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit prokurorial, të garantuara me Kushtetutë dhe ligj;</li> <li>• Kompetencat dhe funksionimi, të përcaktuara qartë me ligj;</li> <li>• Legjislacion sekondar mjaft të konsoliduar;</li> <li>• Qëndrueshmëria e institucionit dhe proceseve të punës për të garantuar funksionalitet të plotë;</li> <li>• Fokusi në reforma;</li> <li>• Fuqia punëtore dhe rritja e numrit të prokurorëve dhe stafit profesional dhe administrativ;</li> <li>• Kapaciteti teknik;</li> <li>• Diversiteti gjinor dhe gjithëpërfshirja;<sup>7</sup></li> <li>• Bashkëpunimi i mirëfilltë ndërinstytucional vendor dhe ndërkombëtar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitetet e pakta për prezantimin e punës së sistemit prokurorial para publikut duke ndikuar negativisht në opinionin publik;</li> <li>• Besimi i publikut;</li> <li>• Nevoja për planifikim më të mirë të stafit dhe riorganizim për të mundësuar kompetencat dhe vijën e qartë hierarkike;</li> <li>• Nevoja për zhvillim profesional, profilizim dhe ngritje të kapaciteteve;</li> <li>• Përdorim jo gjithëpërfshirës i teknologjisë informative;</li> <li>• Sfida në zbatimin e akteve të reja në disiplinë dhe performansë të prokurorëve.</li> </ul>



MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimet teknologjike dhe përdorimi i tyre;</li> <li>• Procesi i rishikimit funksional;</li> <li>• Rritja e buxhetit për t'i plotësuar nevojat e sistemit prokurorial;</li> <li>• Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me pavarësinë e sistemit prokurorial dhe</li> <li>• Rivendosja e aktiviteteve pas COVID-19-shit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjedisi politik;</li> <li>• Mosaprovimi i plotë i kërkesave tona buxhetore;</li> <li>• Ndikimet nga jashtë;</li> <li>• Dinamikat regjionale;</li> <li>• Çështjet e ekspertizave dhe pagesat e ekspertëve;</li> <li>• Aftësi të limituara për të ndikuar në zingjirin e drejtësisë dhe për të pasur sinergji.</li> </ul>

<sup>7</sup> Raporti i Projektit britanik “Vlerësimi gjinor institucional dhe përfshirja sociale e sistemit prokurorial të Kosovës”, 2021.

## OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2022-2024

Mandati kushtetues dhe ligjor i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit synohet të arrihet përmes gjashtë fushave kryesore strategjike, në të cilat ndahet ky plan strategjik. Këto shtylla, përmes objektivave specifike, paraqesin fokusin e sistemit prokurorial për periudhën që mbulon plani në drejtim të fuqizimit të një sistemi profesional, llogaridhënës, të qëndrueshëm, të paanshëm, efektiv, efikas dhe me etikë të lartë të punës.

Ky Plan strategjik përmban edhe Planin e veprimit, ku shtyllat kryesore kanë objektivat e veta specifike, të cilat përmbajnë aktivitete konkrete me njësitë përgjegjëse, afatet kohore dhe treguesit e zbatueshmerisë.

Për më tepër, Plani përmban edhe mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij dhe mekanizmat për monitorim dhe vlerësim.

Shtyllat kryesore të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 janë:

*SHTYLLA 1:* Profesionalizmi dhe pavarësia në sistemin prokurorial

*SHTYLLA 2:* Efikasiteti dhe efektiviteti në ndjekjen e krimit

*SHTYLLA 3:* Profilizimi i prokurorëve dhe trajtimi i rasteve penale me prioritet

*SHTYLLA 4:* Menaxhimi dhe administrimi në sistemin prokurorial

*SHTYLLA 5:* Integriteti, llogaridhënia dhe etika

*SHTYLLA 6:* Transparenca në sistemin prokurorial

## Shtylla 1: Profesionalizmi dhe pavarësia në sistemin prokurorial

### Objektivat specifike

*Objektivi specifik 1:* Avancimi i sistemit të rekrutimit të prokurorëve

*Objektivi specifik 2:* Avancimi i legjislationit për zhvillim në karrierë

*Objektivi specifik 3:* Ngritja profesionale e vazhdueshme e prokurorëve dhe personelit

*Objektivi specifik 4:* Ruajtja e pavarësisë së sistemit prokurorial nga ndërhyrjet e jashtme

Rekrutimi, si proces, avancimi profesional së bashku me ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe ruajtja e pavarësisë së sistemit prokurorial janë një ndër objektivat kryesore permanente, të cilat kërkojnë vëmendje konsistente. Procesit të rekrutimit i kushtohet një vëmendje shumë e madhe, në mënyrë që të sigurohet që në secilën fazë të jetë i bazuar në meritokraci dhe transparencë. Ky proces rrjedh në drejtim të profesionalizmit, duke mundësuar trajtim të barabartë të kandidatëve dhe promovim të integritetit të lartë. Po ashtu, në drejtim të kësaj, procesi aktual kërkon një nevojë për rishikim të akteve nënligjore, duke përfshirë kriteret e vlerësimit dhe duke zhvilluar edhe në faza të mëtutjeshme mundësinë e digjitalizimit të procesit të rekrutimit, pasi momentalisht vetëm procedura e aplikimit bëhet përmes formës elektronike.

Funksionimi i duhur i prokurorive mbështetet edhe përmes avancimeve të prokurorëve dhe transferimeve të përkohshme dhe të përhershme. Kërkesat e vazhdueshme për transferime dhe avancime të prokurorëve nëpër prokurori përkatëse sollën nevojën për akt nënligjor të ri, ku u miratua Rregullorja e re për transferimin dhe avancimin e prokurorëve, në bazë të së cilës do të vazhdojë vlerësimi i nevojave dhe përmbushja e kërkesave duke avancuar gjithnjë proceset e tilla thelbësore.

Profesionalizimi në punë i prokurorëve të shtetit dhe stafit mbështetës është një nevojë e vazhdueshme, duke mundësuar procese dhe punë sa më cilësore. Këshilli, pas miratimit të Rregullores për trajnime dhe zhvillimin profesional në sistemin prokurorial për prokurorët dhe stafin mbështetës, do të vazhdojë të fuqizojë aspektin profesional dhe zhvillimin e karrierës edhe për stafin profesional. Hartimi i politikave të trajnimit të prokurorëve dhe stafit do të vazhdojë në baza vjetore në mbështetje të kërkesave të nevojshme dhe bashkëpunimi me

institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe profesionalizimit në punë.

Zbatimi i mandatit kushtetues dhe ligjor është obligim crucial i sistemit prokurorial. Sistemi prokurorial, si kategori kushtetuese, do të ruajë në mënyrë të vazhdueshme pavarësinë e saj në punë, duke shmangur çdo tendencë për ndërhyrje dhe duke fuqizuar aspektin sigurues për mosinterferime nga jashtë.

Pavarësia institucionale e sistemit prokurorial shtrihet dhe ka fushëveprimtari gjithëpërfshirëse, ndër të tjera, ashtu siç përcaktohet edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

## Shtylla 2: Efikasiteti dhe efektiviteti në ndjekjen e krimit

### Objektivat specifike

*Objektivi specifik 1:* Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve

*Objektivi specifik 2:* Ngritja e nivelit të sekustrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të pasurisë së fituar me veprë penale (me theks të posaçëm në zbatimin më efikas të Ligjit për kompetencat e zgjeruara)

*Objektivi specifik 3:* Zvogëlimi i numrit të lëndëve të Prokurorit të Shtetit, me theks të veçantë në lëndët nga regjistri PPP

*Objektivi specifik 4:* Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante për rritjen e efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e veprave penale dhe inicimin e rasteve penale

*Objektivi specifik 5:* Rritja e efikasitetit në aplikimin e procedurave alternative në zgjidhjen e rasteve penale

*Objektivi specifik 6:* Unifikimi i praktikave të punës përbrenda Prokurorit të Shtetit

*Objektivi specifik 7:* Fuqizimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave të krimit

*Objektivi specifik 8:* Ngritja e efikasitetit për aplikimin e programit të dëshmitarëve dhe sinjalizuesve

*Objektivi specifik 9:* Zgjidhja e çështjes së ekspertëve dhe ekspertimi

*Objektivi specifik 10:* Bashkëpunimi ndërkombëtar, me theks të veçantë në ndihmën juridike ndërkombëtare penale



Prokurori i Shtetit, si institucion i pavarur, me autoritet dhe përgjegjësi për hetimin, ndjekjen penale të personave të dyshuar për vepra penale dhe përfaqësimin në çdo fazë të procedurës penale, do të vazhdojë të jetë i paanshëm dhe i trajton qytetarët në mënyrë të barabartë. Efikasiteti dhe efektiviteti në punën e prokurorit të shtetit bazohet në menaxhimin adekuat të punës, duke pasur mbikëqyrje dhe llogaridhënie të vazhdueshme të punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve.

Këshilli pranon raportime të rregullta të kryeprokurorëve, ashtu siç është përcaktuar me ligj, ku, përmes krijimit të politikave të reja është avancuar metodologjia e raportimit. Këto raportime janë më të detajuara, duke paraqitur pasqyrë të qartë të punës së prokurorive dhe sfidave, me të cilat përballën në punën e përditshme. Ngritja e llogaridhënies, vlerësimi substancial dhe cilësor i punës së Prokurorit të Shtetit do të vazhdojë të jetë vlerë dhe synim që do të ruhet në vazhdimësi. Raportimet e komisioneve të përhershme dhe atyre ad hoc të Këshillit do të realizohen në baza të rregullta.

Puna e Prokurorit të Shtetit kërkon komunikim dhe koordinim sistematik të brendshëm, ku pikësynim është unifikimi i praktikave të punës, duke i shmangur dualizmat dhe duke vazhduar monitorimin e punës së prokurorëve nga prokurorët e ZKPSH-së, përgjegjës për secilën prokurori, përfshirë përfaqësimin sa më profesional dhe me pjesëmarrje aktive në seanca gjyqësore në shkallë të parë dhe në Apel.

Përmes sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të pasurisë së fituar me vepër penale, Këshilli do të synojë kthimin e mjeteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme. Për t'u arritur ky efikasitet, mbikëqyrja e veprimeve të prokurorëve në zbatim të protokolleve për sekuestrim dhe konfiskim të aseteve, me theks të veçantë në identifikimin e aseteve për sekuestrim dhe parashtrimin apo jo të kërkesave për konfiskim.

Efektiviteti i Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e rasteve është i dukshëm në vitet e fundit. Kjo tregohet përmes raporteve vjetore të punës, në të cilat paraqitet përqindja e lartë e rasteve të zgjidhura dhe vendimeve fajësuese të gjykatës. Mirëpo, një problem i vazhdueshëm është numri i lartë i lëndëve nga regjistri me kryes të panjohur (PPP). Statistikisht, ky numër po ndikon negativisht në pasqyrimin real të rezultateve të mira të punës së bërë. Andaj, objektivi kyç i sistemit prokurorial do të

jetë puna vijuese për zvogëlimin e këtyre lëndëve.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ngritja proaktive e këtij bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante për rritjen e efikasitetit në zbulimin dhe hetimin e veprave penale dhe parashtrimin e kallëzimeve penale, me qëllim të arritjes së objektivave të parapara të sistemit prokurorial, do ta ketë rëndësinë e vetë në kuadër të periudhës që mbulon ky plan strategjik.

Aplikimi i procedurave alternative determinon rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në zgjidhjen e rasteve penale me procedurë të veçantë. Zgjidhja e rasteve penale në këtë mënyrë konsiderohet një mjet shumë i rëndësishëm që prokurori mund ta përdorë çdo herë kur të plotësohen kushtet e parapara, me anë të të cilave synohet të rritet numri i referimit të rasteve me procedura alternative. Në prokurori themelore aktualisht janë të caktuar zyrtarët e ngarkuar me ndërmjetësim, mirëpo synohet që të bëhet rekrutimi i zyrtarëve për ndërmjetësim dhe sa i përket aplikimit sa më adekuat të këtyre procedurave, kërkohet fuqizimi i komunikimit mes prokurorisë dhe ndërmjetësuesve. Po ashtu, për ta bërë punën më të qasshme planifikohet të hartohen udhëzime për prokurorë për përdorimin e shtuar të procedurave alternative, ku do të ketë monitorim sistematik dhe raportim të rregullt të zgjidhjes së rasteve me procedura alternative.

Mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e viktimave të krimit, të cilët kanë dëshmuar një performansë dhe sukses adekuat do të vazhdojnë të fuqizohen, duke i dhënë edhe më shumë vlerë dhe trajtim edhe më të kujdesshëm mbrojtjes së viktimave të krimit.

Me qëllim të sensibilizimit të publikut lidhur me mundësinë e përdorimit të linjës ndihmëse në kuadër të ZMNV-së, sistemi prokurorial do të angazhohet në organizimin e fushatave vetëdijësuese dhe informuese për inkurajimin e përdorimit të kësaj linje për raportimin e veprave penale, me theks të veçantë atyre të dhunës në baza gjinore. Po ashtu, do të përmirësohen procedurat e referimit të rasteve nga linjat ndihmëse të institucioneve përkatëse.

Aspekt tjetër i rëndësishëm në vitet e ardhshme do të jetë ngritja e efikasitetit për aplikimin e programit të dëshmitarëve dhe sinjalizuesve, ku në bazë të kornizës ligjore do të caktohet zyrtari përgjegjës në lidhje me sinjalizimin dhe do të ngrihet niveli për aplikimin e programit për

mbrojtjen e dëshmitarëve.

Për një kohë të caktuar ka qenë problematike çështja e ekspertëve dhe ekspertimi, ku në punën e prokurorit ka shkaktuar shumë vështirësi, kur dihet rëndësia dhe pozita e ekspertëve dhe ekspertimit, si akt në procedurë. Koordinimi me institucionet e tjera për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe përcaktimin e tarifave është më se i nevojshëm.

Një tjetër linjë e ngritjes së efikasitetit të ndjekjes së krimit është edhe bashkëpunimi ndërkombëtar, me theks të veçantë në ndihmën juridike ndërkombëtare penale, ku aktualisht janë të caktuar koordinatorët prokurori dhe po ashtu do të vazhdojë edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, Policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera.

### Shtylla 3: Profilizimi i prokurorëve dhe trajtimi i rasteve penale me prioritet

#### Objektivat specifike

*Objektivi specifik 1:* Rritja e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike, krimit të organizuar dhe krimeve kibernetike

*Objektivi specifik 2:* Identifikimi dhe rritja e numrit të rasteve të shënjestuara

*Objektivi specifik 3:* Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve të terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore

*Objektivi specifik 4:* Ngritja e efikasitetit në trajtimin e krimeve të luftës

*Objektivi specifik 5:* Prioritezimi i trajtimit të rasteve të dhunës në familje, sulmet ndaj gazetarëve, krimeve të urrejtjes dhe krimet ndaj pronësisë intelektuale

Veprat penale me prioritet përmbajnë në vete elemente specifike që kërkojnë trajtim të veçantë. Me këtë qëllim, për të rritur efikasitetin në trajtimin e këtyre rasteve, sistemi prokurorial në vazhdimësi ka për objektiv që prokurorët t'i profilizojë për të ngritur profesionalizëm në hetimin e këtyre veprave specifike.

Trajtimi i rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike ka qenë ndër vite prioritet i sistemit prokurorial. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe zvogëlimit të lëndëve të pazgjidhura të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, Këshilli kishte miratuar Planin

strategjik (2016-2018) për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Përmes kësaj strategjie, u themelua Njësi për Luftimin e Korrupsionit dhe Krime Ekonomike në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, ngaqë kjo prokurori gjer në fund të vitit 2015 kishte numrin më të lartë të rasteve të pazgjidhura të korrupsionit në nivel vendi apo 66% dhe 50% të rasteve të krimeve ekonomike. Për të mbikëqyrur dhe vlerësuar punën e këtij Njësi, po ashtu dhe punën e prokurorëve të shtetit që trajtojnë veprat e korrupsionit dhe krimeve ekonomike në prokuroritë e tjera, Këshilli ka themeluar Komisionin Mbikëqyrës, i cili në baza të rregullta harton raporte dhe jep rekomandime të mëtejme. Ky Njësi fillimisht për disa vite ka funksionuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe në atë për Krime të Rënda të Prokurorinë Themelore të Prishtinës. Mirëpo, gjatë vitit 2021, Këshilli ka marrë vendim për shuarjen e këtij njësi në DP dhe tani është funksional vetëm në DKR.

Prokurorët e këtij njësi janë të profilizuar në këtë fushë dhe trajtojnë me prioritet të lartë vetëm këto raste. Në këtë drejtim, në krahasim me fundvitin 2015, numri i rasteve të pazgjidhura të korrupsionit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës në fund të vitit 2021 është zvogëluar për 62%, ndërsa numri i rasteve të pazgjidhura të krimeve ekonomike është zvogëluar për 46%. Meqenëse, ky njësi ka treguar efikasitet në trajtimin e këtyre rasteve, si dhe duke pasur parasysh se kjo prokurori ka në punë me afro 40% të rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në nivel vendi, Njësi do të vazhdojë së funksionuari dhe do të përkrahet nga Këshilli sipas nevojave. Po ashtu, Komisioni Mbikëqyrës do të bëjë monitorimin e të gjitha prokurorive në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Sistemi prokurorial, në vitet në vazhdim, do të përqendrohet në format më të shprehura të kriminalitetit, por pa përjashtuar edhe format e tjera, siç janë: pastrimi i parave, krimi i organizuar, krimet kibernetike, terrorizmi, sulmet ndaj gazetarëve, trafikimi i qenieve njerëzore, krimet e urrejtjes dhe krimet ndaj pronësisë intelektuale. Trajtimi me prioritet i këtyre veprave penale është kërkesë e vazhdueshme e mekanizmave ndërkombëtarë. Në këtë drejtim, sistemit prokurorial do të fokusohet në plotësimin e nevojave të prokurorive me qëllim të ofrimit të kushteve sa më të mira për trajtim sa më të suksesshëm dhe profesional të këtyre rasteve specifike. Kjo përfshin rritjen e numri të prokurorëve, stafit profesional dhe mbështetës dhe ngritjen e

bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar.

Që nga viti 2015 vazhdon të funksionojë Ekipi i përbashkët për shenjëstrimin e rasteve me koordinatorë, Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, i cili përfshin edhe një numër të institucioneve relevante. Ky ekip mban takime të rregullta dhe bazuar në procedurat standarde të veprimit, identifikojnë dhe shenjëstrojnë krimet e rënda të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimet të organizuar. Me qëllim të identifikimit dhe shenjës trimit të rasteve të kësaj natyre do të vazhdojë koordinimi me autoritetet kompetente në këtë drejtim.

Për trajtimin me prioritet të rasteve të krimeve të luftës, Këshilli Prokurorial i Kosovës kishte miratuar Strategjinë për Krime të Luftës në vitin 2019, që, në këto tre vjet ka qenë bazë për fuqizimin e kapaciteteve dhe procedurave për trajtimin e këtyre rasteve. Gjatë viteve paraprake, Këshilli ka fuqizuar Departamentin për Krime të Luftës dhe në vitet e ardhshme do të jetë një ndër prioritetet e sistemit prokurorial, duke e mbështetur këtë departament me resurse shtesë. Meqenëse, Strategjia për Krime të Luftës përfundon në fund të vitit 2021, fillimisht do të bëhet një analizë për zbatimin e kësaj strategjie dhe nevojën e hartimit të strategjisë së re.

Dukuria e dhunës në familje dhe numri i rasteve është në vazhdimësi i lartë, gjë që kjo vepër penale paraqet shqetësim serioz për shoqërinë tonë. Sistemi prokurorial i ka kushtuar rëndësi trajtimit të këtyre rasteve me prioritet të lartë në mënyrë konsistente. Në këtë drejtim kanë vazhduar punën koordinatorët e caktuar për secilën prokurori themelore, duke ofruar trajtim më efikas dhe dinjitoz për viktimat e dhunës në familje. Lidhur me trajtimin e këtyre rasteve ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me mbrojtësit e viktimave dhe Policinë e Kosovës. Mirëpo, meqenëse, kjo dukuri vazhdon të mbetet shqetësuese, ky angazhim do të fuqizohet edhe më tej me të gjitha resurset e nevojshme. Kapacitetet profesionale të prokurorive dhe mbrojtësve të viktimave do të vazhdojnë të fuqizohen, me qëllim të reagimit sa më të shpejtë, identifikimit të rasteve më serioze, vlerësimit të rrezikshmërisë në çdo rast, trajtimit profesional dhe dinjitoz, si dhe prioritetizimin e vazhdueshëm të rasteve.

## Shtylla 4: Menaxhimi dhe administrimi në sistemin prokurorial

### Objektivat specifike

*Objektivi specifik 1:* Rishikimi dhe adaptimi i kornizës nënligjore

*Objektivi specifik 2:* Riorganizimi i administratës së sistemit prokurorial

*Objektivi specifik 3:* Avancimi me prioritet i diversitetit gjinor në sistemin prokurorial

*Objektivi specifik 4:* Qëndrueshmëria institucionale ndaj krizave (menaxhimi i krizave)

*Objektivi specifik 5:* Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

*Objektivi specifik 6:* Proceset buxhetore dhe financiare

*Objektivi specifik 7:* Avancimi i infrastrukturës fizike dhe nivelit të sigurisë në sistemin prokurorial

*Objektivi specifik 8:* Avancimi i digjitalizimit të punës së prokurorisë (e-prokuroria)

*Objektivi specifik 9:* Avancimi i statusit dhe rolit të prokurorëve dhe stafit administrativ

Synim i sistemit prokurorial është që të ruhet karakteri unitar i tij dhe të bazohet në parimet e pavarësisë dhe subordinimit, si baza përcaktuese për shumicën e sistemeve prokuroriale.

Çdo iniciativë apo veprim tjetër ligjor i institucioneve kompetente për ndryshime ligjore, në procesin e hartimit të legjislacionit që rregullon sistemin e drejtësisë dhe ndikon në sistemin prokurorial, duhet të përfshijë kërkesat dhe propozimet e sistemit prokurorial në procesin për plotësimndryshime të reja në legjislacionin aktual.

Me qëllim të harmonizimit dhe përditësimit të akteve nënligjore dhe përshtatjes me ndryshimet e reja eventuale ligjore dhe strukturore, Këshilli, përmes mekanizmave të vet, do të bëjë analizën e zbatimit të akteve nënligjore në fuqi. Pas analizës së bërë do të bëhen plotësimndryshimet e nevojshme, me qëllim të përditësimit dhe harmonizimit të akteve nënligjore dhe përshtatjes së tyre me ndryshimet e reja eventuale ligjore dhe strukturore.

Kërkesë e vazhdueshme e institucionit tonë dhe mekanizmave ndërkombëtarë ka qenë fuqizimi i efektivitetit të administratës së

sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe atij prokurorial në veçanti. Në këtë drejtim, Këshilli ka filluar procesin e reformimit të administratës së sistemit prokurorial, ku një hap i madh do të bëhet në reformimin e prokurorive dhe krijimit të vijës së qartë hierarkike. Kjo do të kontribuojë në qartësimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës dhe do të ketë ngjitje evidente të llogaridhënies.

Sistemi prokurorial i Kosovës ka zbatuar vazhdimisht dispozitat kushtetuese dhe ligjore sa i përket integritimit dhe diversitetit gjinor. Gjatë vitit 2021, nga Projekti britanik "Fuqizimi i sistemit të drejtësisë" është zhvilluar një studim që ka për bazë diversitetin gjinor në sistemin prokurorial, i cili ka dëshmuar se sistemi ynë ka avancuar në këtë drejtim, duke mos pasur barriera me baza gjinore në rekrutim apo avancim të prokurorëve dhe stafit të administratës<sup>8</sup>. Kjo çështje do të jetë në fokus edhe në vitet në vazhdim.

Pas paraqitjes së rasteve të para me COVID-19 në Kosovë, më 13 mars 2020, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtje nga kjo pandemi, duke zbatuar vendimet dhe udhëzimet e institucioneve të vendit.

Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe sfidat që janë paraqitur si rezultat i saj, sistemi prokurorial do të fokusohet në vitet në vijim në fuqizimin e kapaciteteve dhe proceseve të brendshme për të krijuar qëndrueshmëri ndaj çfarëdo krize që mund të paraqitet<sup>9</sup>.

Sistemi prokurorial ka zbatuar politikat e bashkëpunimit profesional dhe proaktiv me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të mandatit ligjor. Në këtë drejtim, Këshilli dhe Prokurori i Shtetit kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe kanë përfutur projekte të ndryshme në vazhden e bashkëpunimit ndërinstitutional, përmes së cilave kanë fuqizuar koordinimin ndërinstitutional në realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor, me fokus të veçantë në luftimin e dukurive kundërligjore.

8 "Në pesë vjetët e fundit ka një trend të qartë të rritjes së numrit të femrave prokurorë. Ndërsa, femrat përbënin vetëm 37.4% të prokurorëve në vitin 2018, ky trend është rritur gradualisht në 43% në vitin 2021." "Sa i përket stafit administrativ në prokurori të ndryshme, situata duket krejt ndryshe. Në përgjithësi, burrat janë të nënpërfaqësuar në radhët e personelit administrativ në të gjitha prokuroritë e Kosovës, me përjashtim të Prokurorisë Themelore të Pejës."

9 Vendimi i Qeverisë nr. 01/33 i datës 30.08.2021, ku një përfaqësues i ZKPSH është anëtar i Komitetit për koordinimin dhe vlerësimin e situatës me pandeminë COVID-19.



Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar dhe përkrahja nga partnerët dhe donatorët është një shtyllë e rëndësishme për fuqizimin e sistemit prokurorial dhe rrjedhimisht do të mbetemi të përkushtuar për zbatimin e politikave të bashkëpunimit të hapur dhe profesional.

Kërkesat buxhetore e sistemit prokurorial planifikohen dhe hartohen në konsultim me të gjitha prokuroritë dhe aprovohen nga Këshilli, si dhe propozohen për miratim pastaj në Ministrinë e Financave dhe në Kuvend. Këshilli ka bërë përpjekje në vazhdimësi për ngritjen e kufijve buxhetorë, duke pasur parasysh kërkesat e vazhdueshme për avancim të proceseve dhe kapaciteteve, të cilat faktikisht kërkojnë mjete më të larta buxhetore. Pavarësisht faktit që buxheti ka shënuar rritje, sidomos për vitin 2022, si dhe buxheti i miratuar për sistemin prokurorial është më i larti që kemi pasur deri tashti, mungesa e mjeteve në disa kategori ekonomike ende mbetet sfidë e Këshillit.

Me qëllim të lehtësimit të procedurave të brendshme, Këshilli planifikon të zhvillojë dhe implementojë sistemin elektronik për menaxhimin e buxhetit dhe financave.

Sfidë mbetet edhe pavarësia buxhetore, si një ndër çështjet kyçe të funksionimit të sistemit prokurorial, e cila duhet të garantohet me Kushtetutë dhe ligj.

Buxheti i sistemit prokurorial duhet të jetë i qëndrueshëm, gjithëpërfshirës, i menaxhuar përmes sistemeve të avancuara dhe procedurave standarde të kontrollit dhe mbikëqyrjes së menaxhimit të buxhetit dhe financave, duke përfshirë edhe të hyrat nga Këshilli dhe donatorët.

Infrastruktura mbetet ende sfidë në disa prokurori. Sigurimi i infrastrukturës adekuate është kusht i domosdoshëm për sigurimin e efikasitetit dhe efektivitetit në punë. Gjatë periudhës paraprake, Këshilli ka siguruar ndërtimin e objekteve dhe ka bërë avancimin e sigurisë në disa nga prokuroritë dhe kanë filluar procese edhe për disa prokurori të tjera. Sfiduese mbetet objekti i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës për shkak të vështirësive për sigurimin e parcelës për ndërtim, duke pasur parasysh kufizimet që parashihen me Marrëveshjen e Brukselit për Drejtësi.



Siguria në objektet e sistemi prokurorial është avancuar me resurse njerëzore dhe teknike në të gjitha prokuroritë. Në të ardhmen, Këshilli do të angazhohet për të avancuar sistemin e sigurisë duke u bazuar në nevojat e paraqitura dhe hapësirat për përmirësime, që përfshijnë rekrutimin e zyrtarëve të brendshëm, të cilët ofrojnë siguri.

Këshillit Prokurorial i Kosovës është duke ndërmarrë vazhdimisht hapa në drejtim të reformave në sistemit prokurorial, me qëllim të futjes së teknologjisë informative (TI) me theks të veçantë në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) nëpër prokurori, i cili do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe transparencës. Një ndër synimet e KPK-së është digjitalizimi i plotë i proceseve të punës në sistemin prokurorial, duke zëvendësuar punën manuale me atë elektronike që do të ndikojë në ofrimin e shërbimeve cilësore, të shpejta dhe të sakta, si dhe gjenerimin e raporteve në kohë reale.

Këshilli Prokurorial është i përkushtuar që të angazhohet në avancimin e statusit të prokurorëve dhe stafit administrativ, përmes kontributit në hartimin e ligjeve që kanë të bëjnë me këtë çështje.

## Shtylla 5: Integriteti, llogaridhënia dhe etika

### Objektivat specifike

*Objektivi specifik 1:* Avancimi i proceseve dhe kontrolli permanent për fuqizimin e integritetit të prokurorëve

*Objektivi specifik 2:* Zbatimi adekuat i sistemit të ri të vlerësimit të performansës së prokurorëve

*Objektivi specifik 3:* Fuqizimi i përgjegjësive disiplinore të prokurorëve

*Objektivi specifik 4:* Zbatimi i parimit të subordinimit dhe hierarkisë

Kontrolli sistematik i fuqizimit të integritetit të prokurorëve përfshin reformimin e këtyre proceseve dhe është një objektivi i sistemit prokurorial që në të ardhmen të krijohen mekanizma të përhershëm të brendshëm për të kontrolluar dhe verifikuar integritetin dhe etikën e prokurorëve.

